



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË



Në mbështetje të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, (Ligji Nr.03/L-040) nenit 12, 17 shkronja (n), 40.2 shkronja (a), Ligjit për Transportin Rrugor nenit 6, 14, 19.2, 38, 39, 41, si dhe duke u mbështetur në nenin 12 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur më **05/03/2010**, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E **PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME** **AUTOTAKSI DHE KOMBITAKSI**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.

Neni 1

Me këtë Rregullore caktohet kryerja e veprimtarisë autotaksi dhe kombitaksi (në tekstin e mëtutjeshëm Autotaksi) për Transportin e udhëtarëve me automjet në teritorin e komunës së Malishevës.

Neni 2

Transporti i udhëtarëve është veprimtari, të cilën e kryen vozitësi me automjetin për të cilin relacioni dhe kushtet tjera caktohen për secilin transport në veçanti.

Neni 3

3.1. Asnjë Autotaksi dhe Kombitaksi nuk lejohet ta ushtrojë veprimtarinë e tij brenda territorit komunal, Pa Leje Pune Komunale.

3.2 Transportin e udhëtarëve me automjetin taksi mund ta kryejnë personat fizik, të cilët e kanë veprimtari të vetme, si dhe ndërmarrjet (personat juridik), të cilat i plotësojnë kushtet e caktuara me ligj dhe me këtë Rregullore.

KUSHTET PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT ME AUTOTAKSI

a) Personat fizik:

Neni 4

Përpos kushteve të parapara me ligj për kryerjen e transportit me autotaksi, personi fizik duhet t'i përmbushë këto kushte:

1. të posedojë lejen e vozitjes për kategorinë përkatëse;
2. të jetë pronar i automjetit të regjistruar me të cilin kryen veprimtarinë;
3. të ketë vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Malishevës;
4. të mos ketë të shqiptuar masë mbrojtëse të ndalimit të kryerjes së transportit për autotaksi, më tepër se 6 muaj.

Dispozitat nga alinea 1 pika 4 e kësaj Rregulloreje nuk do të aplikohen nëse kanë kaluar 3 vjet nga dita e skadimit të ndalesës.

Personi fizik e kryen këtë veprimtari me automjetin, të cilin e ka në pronësi të veten të cilin vetë e drejton dhe i njejti është i regjistruar për transportin autotaksi.

b) Personat juridik.

Neni 5

Për kryerjen e transportit në cilësi të autotaksit personi juridik duhet t'i plotësojë këto kushte:

1. që të jetë i regjistruar për këtë lloj transporti;
2. që vozitësit e taksive t'i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 4 të kësaj Rregulloreje;
3. që automjetet me të cilat kryhet transporti i udhëtarëve të jetë në pronësi të personit juridik;
4. që të ketë selinë në territorin e komunës së Malishevës.

II. PUNËT ADMINISTRATIVE

Neni 6

Kërkesa për kryerjen veprimtarisë, në cilësi të autotaksit i bëhet Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet .

Kërkesës i bashkëngjiten edhe dëshmitë për plotësimin e kushteve të parapara në këtë Rregullore.

Aktvendimi mbi kryerjen e transportit në cilësi të autotaksit e lëshon Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet (Zyra për licencim – leje), kurse për Kombitaksit e lëshon organi komunal që merret me transportin urban.

Neni 7

Pas lëshuarjes së Aktvendimit, lëshohet *Leja e punës*, e cila është valide gjer me datën e skadimit të regjistrimit të automjetit.

Përsoni i cili ushtron veprimtarinë e autotaksi merr obligim që 7 ditë para skanimit të afatit të Lejes së punës të bëjë kërkesën për vazhdimin e së njëjtës.

Gjithashtu autotaksi është i obliguar që t'i paraqes organit kompetent të gjitha të dhënat në rast të ndryshimit të gjendjet teknike apo të shënimeve të tjera të cilat janë në lejen e punës, për automjetin me të cilin kryen veprimtarinë(ndërrimin e automjetit,ndërrimin e adresës etj).

Formën dhe përmbajtjen e Lejes së punës për autotaksi, organi kompetent do ta definoj me aktvendim të posaçëm.

B) Ndërprerja e përkohshme e kryerjes së transportit në cilësi të autotaksit.

Neni 8

Përsoni apo subjekti juridik ka të drejtë përkohësisht të ndërpresë kryerjen e transportit në cilësinë e autotaksit në këto raste:

1. kur ka pushim mjekësor;
2. pushim i lehonisë;
3. aftësim profesional;
4. pushim vjetor me kohëzgjatje prej 30 ditësh gjatë vitit kalendarik;
5. riparimet e automjetit me të cilin kryen transportin e udhëtarëve me kohëzgjatje prej tre muajsh gjatë vitit kalendarik; dhe
6. paraburgimit apo vuajtjes së dënimit me kohëzgjatje prej 6 muaj.

Neni 9

Personi fizik apo juridik i cili ushtron veprimtarinë e autotaksit i bën kërkesë organit kompetent, për ndërprerjen e përkohëshme të veprimtarisë 5 ditë nga paraqitja e rrethanave nga neni 8 i kësaj Rregulloreje.

Bashkë me kërkesën paraqitësi ia bashkangjet edhe Lejen e punës.

Ndërprerja e kryerjes së transportit me autotaksi

Neni 10

Personi fizik apo juridik e ndërpreu veprimtarinë e autotaksit në këto rrethana:

1. me kërkesën për çregjistrimin e veprimtarisë;
2. në rast të sëmundjes së rëndë apo vdekjes së personit;
3. me paraqitjen e rrethanave të cilat janë në pajtim me dispozitat e nenit 4 të kësaj Rregulloreje;

Neni 11

Personi fizik dhe juridik, i cili ushtron veprimtarinë e autotaksit, është i obliguar që në rast të ndërprejes së veprimtarisë (neni 10), organit i cili e ka lëshuar aktvendimin dhe lejen, është i obliguar që t'ia kthejë që të dyjat dhe të fshihet nga regjistri.

IV. AUTOMJETET PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT AUTOTAKSI

Neni 12

Automjeti i udhëtarëve për kryerjen e transportit autotaksi dhe kombitaksi (në tekstin e mëtejshëm automjeti taksi), pos kushteve të rregulluara me ligj duhet t'i përmbushë edhe këto kushte:

1. të ketë më së shumti 8+1 ulëse ;
2. të ketë së paku 4 dyer;
3. të ketë taksimetrin i cili duhet teknikisht të jetë në rregull, dhe i vendosur në atë pozitë që shuma të cilën e regjistron të jetë e dukshme për udhëtar;
4. që nxemja dhe ajrosja të funksionojnë në rregull;
5. që të ketë shenjën „TAXI” të vendosur mbi kulm të automjetit si dhe e njëjta gjatë kohës së errët dhe gjatë natës të jetë e ndriçuar;
6. çmimet e shërbimeve të jenë në vend të dukshëm për udhëtarin ;
7. që autometi të jetë i pastër dhe i pa dëmtuar;
8. që reklamat, rekomandimet dhe shenjat tjera të mos jenë mbi sipërfaqet e xhamit, në pjesën e përparme dhe të prapme të automjetit;
9. të posedoj aparatën për fikjen e zjarrit, shenjën për ndalimin e pirjes së duhanit
10. të posedojë librin e faturave;
11. automjeti të jetë teknikisht në gjendje të rregullt për transportin e udhëtarëve.

Neni 13

Me automjet taksi nuk mund të transportohen:

1. fëmijët gjer në moshën 6 vjeçare, pa përcjellës, përveç nëse prindi apo kujdestari me marrëveshje me vozitësin e taksisë, ia ka besuar fëmijën për transport gjer në vend të caktuar;
2. personat nën ndikim të alkoolit apo drogës, si dhe personat e sëmurë me sëmundje ngjitëse;
3. personat që me veshmbathjen e tyre mund të dëmtojnë apo ndotin brendësinë e automjetit;
4. kufomat;
5. kafshët dhe shpezët e gjalla apo të ngordhura dhe
6. materialet eksplozive, radioaktive, helmuese, që ndizen lehtë, infektive dhe të tjera, të cilat për shkak të vetive mund të jenë të rrezikshme për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve apo shkaktojnë dëmtim tjetër.

Neni 14

14.1. Pronari i automjetit i cili vepron në kundërshtim të nenit 3.1 të kësaj Rregulloreje kryen transportin e udhëtarëve në cilësinë e Autotaksisë apo Kombitaksisë, haset duke punuar nga Inspektori komunal, si dhe nga Policia e Kosovës-Malishevë do të përjashtohet nga trafiku, apo mundet edhe të dërgohet me marimang në vendin e kontraktuar nga KK për ndalim të automjeteve.

14.2. Me këtë rast pronarit të automjetit do t'i merret (konfiskohet) leja e qarkullimit dhe targat e regjistrimit në kohëzgjatje prej 5 ditësh.

14.3. Njëherësh me rastin e konfiskimit të lejes së qarkullimit dhe targave të regjistrimit të automjetit pronarit të automjetit do të mundë t'i shqiptohet gjoba MANDATORE në shumen prej 50 (pesëdhjetë) €.

14.4. Lejen e qarkullimit dhe targat e automjetit do t'i jepen pronarit të automjetit, vetëm pas kalimit të afatit të paraparë dhe pagesës së gjobës mandatore. Nëse edhe pas kalimit të këtij afati në rast të mos pagesës së gjobës mandatore nuk do t'i jepen leja e qarkullimit dhe targat e regjistrimit të automjetit pronarit deri me pagesën e gjobës mandatore.

14.5. Aktvendimin për përjashtimin e automjetit nga trafiku e lëshon punëtori i autorizuar administrativ (Inspektori i Komunikacionit).

14.6. Pasojat për shpenzimet e krijuara për shkak të aplikimit të paragrafit 1 të këtij neni i bartë pronari i automjetit – vozitësi.

14.7. Nëse taksi nuk është në kryerje të veprimtarisë së vetë dhe, automjetin e shfrytëzon për nevojat e veta, ka për obligim që ta heqë shenjën „TAXI”.

14.8. Automjetet e regjistruara për transportin e udhëtarëve, në cilësinë e taksisë të cilat janë të regjistruara në territorin e komunave tjera, nuk guxojnë të pranojnë udhëtarë në territorin e Komunës së Malishevës, pos në raste kur sjellin udhëtarët nga komunat tjera, njëherit kërkohet që ti përmbushë kushtet nga neni 12 i kësaj Rregulloreje.

14.9. Me automjetin autotaksi dhe kombitaksi nuk guxon të transportohen numër më i madh i udhëtarëve se sa janë të regjistruara ulëset në automjet.

VENDQENDRIMET E TAKSIVE

Neni 15

Vendqendrimi i taksive dhe kombitaksive është sipërfaqe e destinuar për parkimin e automjeteve të tyre, dhe mund të caktohet për pagesë një shumë e mjeteve për një vjet. Vendqendrimi i tyre shënohet me shenjën përkatëse të trafikut .

Neni 16

Për caktimin dhe mirëmbajtjen e vendqënimeve për taksi dhe kombitaksi, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut kujdeset organi kompetent komunal.

Neni 17

Në vendqëndrimet e taksive respektohet rendi i parkimit i cili formohet nga radha e vetë taksive. Vozitësi është i obliguar të jetë në automjet gjatë kohës derisa gjindet në vendqëndrimin e taksive. Autotaksi mund të marrë udhëtarë për transport jashtë vendqëndrimit të taksive në ato vende, ku nuk ndalohet parkimi dhe ndalja e automjeteve, me kërkesën e udhëtarit

V. TRANSPORTI I TAKSIVE

Neni 18

Autotaksi është i obliguar që të pranojë për transport çdo udhëtar në kufijtë e ulëseve që ka në dispozicion, si dhe bagazhin e udhëtarëve në kufijtë e sipërfaqes hapësirës që disponon për bagazh, përveç gjërave dhe udhëtarëve që janë në kundërshtim me nenin 13 të kësaj Rregulloreje. Taksisti është i obliguar që ndaj udhëtarëve të sillet me kujdes dhe korrektësi.

Neni 19

Taksisti është i obliguar që transportin ta fillojë :

- a) nga vendqëndrimi dhe vendbanimi;
- b) sipas thirrjes së qytetarit të interesuar (thirrjeve telefonike etj.)

Neni 20

Transporti taksi, fillon me hyrjen e udhëtarit në automjet. Taksisti është i obliguar që të kyçë taksimetrin me rastin e fillimit të vozitjes.

Neni 21

Taksisti është i obliguar që transportin ta kryejë nëpër rrugët që i cakton udhëtari, gjegjësisht nëpër rrugët më të shkurta gjër te vendi i përcaktimit të udhëtarit.

Neni 22

Kombitaksi është i obliguar që gjatë gjithë kohës të ketë të vendosur relacionin e udhëtimit në automjet në vend të dukshëm për udhëtarët. Taksisti është i obliguar që gjatë punës së tij të jetë i pastër, i rruar, i qethur apo me mustaqe dhe mjekër të rregulluar, veshëmbathja të jetë e pastër etj.

Taksisti gjatë kryerjes së punës nuk guxon të jetë i veshur me pantollona të shkurtër, me shorce me ndërresë pa mëngë përkatësisht këmbishë apo ndërresë, pa këpucë, patika apo pa sandale në këmbë.

Neni 23

Kur taksisti nuk kryen transportin e udhëtarëve ka për detyrë të heqë shenjën „TAXI” nga automjeti.

VI. KOMPENZIMI PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT ME TAKSI

Neni 24

Kompenzimin për kryerjen e shërbimit me taksi e kryen udhëtari në bazë të çmimoreve që tregon taksimetri. Në shumën e kompenzimit është llogaritur edhe transporti i bagazhit.

Me kërkesën e udhëtarit taksisti është i obliguar të lëshojë faturën për shërbimin e kryer.

Neni 25

Në rast të pamundësisë së kryerjes së transportit të filluar, taksistit i takon si kompenzim gjysma e shumës të cilën në momentin e ndërprerjes së transportit e tregon taksimetri.

Taksisti është i obliguar që në rastin nga paragrafi 1. i këtij neni të sigurojë automjet tjetër për vazhdimin e transportit të udhëtarit deri te vendi i nevojshëm për udhëtarin.

Neni 26

Për pranimin e udhëtarëve të tjerë gjatë transportit deri te vendi i përcaktimit, vendos udhëtari i cili e ka filluar shfrytëzimin e taksit me pëlqimin e taksistit.

Neni 27

Nëse më tepër udhëtarë shfrytëzojnë njëkohësisht transportin me taksi deri te vendi i njëjtë i përcaktimit, kompenzimin për kryerjen e transportit e paguan udhëtari i cili e ka filluar shfrytëzimin e taksit.

VII. MBIKQYRJA

Neni 28

Mbikqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje e bënë organi kompetent komunal i administratës dhe Policia e Kosovës.

VIII. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 29

29.1. Personi përgjegjës apo ngasësi i automjetit haset në kundërshtim me nenin 3.1 të kësaj Rregulloreje ka bërë kundërvajtje dhe lënda do të procedohet për Gjykatën Kundërvajtëse dhe do të dënohet nga Gjykata për kundërvajtje në shumën prej: 150-250 €.

29.2 Me shumen prej 50-150 €, do të dënohet taksisti për kundërvajtje nëse:

- nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 7 dhe 9;
- nëse automjeti me të cilin e ushtron veprimtarinë nuk i përmbushë kushtet nga neni 12 i kësaj Rregulloreje.

Neni 30

Me dënim prej 50 € denohet taxi-sti për kundërvajtje nëse :
nuk vepron në harmoni me dispozitat e nenit 22.

Neni 31

Me dënim prej 50-100 € do të dënohet për kundërvajtje taksisti nëse:

- 1.bënë transportin taksi në kundërshtim me nenin 13;
- 2.nuk vendos mjetin sipas rradhitjes në vendqëndrim (sipas nenit 17);
3. nëse nuk kryen shërbimin nëpër rrugën të cilën i cakton udhëtari,përkatesisht nëpër rrugën më të shkurtër (neni 21);
- 4.nuk e kyq taksimetrit gjatë kryerjes së shërbimit për udhëtarët (neni 20);
- 5.nëse bëjnë kompenzimin e shërbimit në shumë më të madhe se që regjistron taksimetri;
- 6.nëse vepron në kundërshtim me nenin 26 të kësaj Rregulloreje.

Për kundërvajtje nga pika 1 dhe 6 e këtij neni nga Gjykata kompetente kundërvajtëse pas kërkesës së bërë nga Inspektori i Komunikacionit do të shqiptohet masa e mbrojtëse e ndalimit të kryerjes së veprimtarisë së tij në kohëzgjatje prej 6 muaj.

Neni 32

Me dënim prej 100-250 €, do të dënohet nga Gjykata për kundërvajtje personi juridik, dhe personi përgjegjës apo drejtuesi i automjetit, nëse nuk vepron në harmoni me dispozitat e nenit 8 dhe 11, si dhe nëse haset në kundërshtim me nenin 14.9

Neni 33

Të hyrat e krijuara nga dispozitat ndëshkimore të kësaj Rregulloreje janë të hyra të buxhetit të Komunës së Malishevë.

IX. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 34

Organi komunal i administrates, kompetent në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të marrë aktvendim për formën dhe përmbajtjen e Lejes (licencës) për taksi (neni 7 paragrafi 4).

Neni 35

Procedura e filluar sipas kërkesës për kryerjen e transportit me taksi lidhur me të cilën nuk është marrë aktvendimi deri në hyrjen në fuqi të kësaj, do të vazhdohet sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 36

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet, Drejtoria e Inspektoratit, Policia e Kosovës-Malishevë

Neni 37

Me miratimin e kësaj Rregulloreje bie nga fuqia Rregullorja nr.01/863 e datës 22/10/2003.

Neni 38

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Nr. 01/ 305

Datë 15 / 03 2010

Kryesuesi i Kuvendit

Ragip Begaj

